Bundesministerium
Bildung

ibobb

Informacion për instrumenti për orientimin arsimor dhe të karrierës (BBO Tool) "E ardhmja juaj" për nxënësit e klasës së 7-të

Të nderuar prindër dhe kujdestarë!

Arsimi dhe orientimi profesional në klasën e 7-të dhe të 8-të shërben për përgatitjen në marrjen e vendimit për karrierën e mëtejshme shkollore pas klasës së 8-të ose për hapat e mëtejshëm për një kualifikim të përshtatshëm profesional.

Nga viti shkollor 2021-22 nxënësve do t'u jepet mundësia të plotësojnë një formular në internet si pjesë të lëndës së detyrueshme të "Orientimit profesional". Instrumenti për orientimin arsimor dhe për karrierën (BBO Tool) synon të mbështesë të rinjtë në fillim të klasës së 7-të për vlerësimet e para të tyre në lidhje me vendimin për shkollimin dhe kualifikimin e mëtejshëm. Synimi është që nxënësit të mendojnë aktivisht për të ardhmen e vet. Të rinjtë duhet të ndërgjegjësohen për hapat e nevojshëm që të mund të marrin vendimin e duhur për shkollimin sekondar ose kualifikimin profesional. Për ta bërë këtë, ju do të merrni çdo rezultat individual menjëherë pas plotësimit të formularit, çka do t'ju japë sugjerime për hapat e mëtejshëm të rekomanduar në fushën e orientimit arsimor dhe të karrierës.

Nëse keni dëshirë që vajza apo djali juaj të marrë këshillim pas plotësimit, mund ta konfirmoni këtë si prind apo kujdestar me nënshkrimin tuaj në fletën individuale të rezultateve. Kjo i mundëson një mësuesi që ka kualifikimin e duhur, t'u hedhë një sy rezultateve të vajzës apo djalit dhe t'i këshillojë për më tej.

Ne do të donim gjithashtu t'ju inkurajojmë ta mbështesni vajzën apo djalin tuaj në këtë proces të rëndësishëm për zgjedhjen arsimore dhe të kualifikimit profesional, si dhe do të ishte kënaqësi për ne nëse mund t'i shikoni dhe vetë përmbajtjen dhe shërbimet e orientimit arsimor dhe profesional në faqen https://portal.ibobb.at/.

Ekipi i BBO Tool i BMB (Ministria Federale e Arsimit)

ALBANISCH